



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 68

Prishtinë, më 20.4.2010, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Naim Maloku, Zulfi Merxha, Haset Cakolli, Berat Luzha, Elheme Hetemi, Selvie Halimi, Myrvete Pantina, Zef Morina.

Mungoi : Naser Rugova, Ali Lajçi, Branislav Grbić.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : zyrtar nga MBPZHR, bashkëpunëtor tjerë, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar .

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku.

Mbledhjen e kryesoi **Naim Maloku**, nënkryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 6.4.2010,
3. Projektligji për ndryshim e plotësim të Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore,
4. Të ndryshme.

1. Nënkyetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e **rendit të ditës**, për të cilat nuk kishte vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 6.4.2010

Nënkyetari konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

3. Projektligji për ndryshim e plotësim të Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore

Nënkyetari Naim Maloku fillimisht njoftoi zyrtarët e MBPZHR se në mbledhjen e parë pas miratimit në parim të projektligjit, si zakonisht caktohet grupi punues i cili merret me projektligjin, ndaj kërkoi nga ata bashkëpunim të plotë me grupin punues e cila do të caktohet nga komisioni në vijim. Komisioni u pajtua që **Zef Morina, Elheme Hetemi** dhe këshilltari **Qazim Kukalaj** të shqyrtojnë projektligjin për ndryshimin e ligjit për ujitjen e tokave bujqësore, pastaj me të përfunduar të paraqesin rekomandimet komisionit për miratim.

Zef Morina caktoi takimin e parë të grupit punues të enjten më 22.4.2010 pas ceremonisë që do të organizohet me rastin e ditës botërore të tokës (në orën 11,00).

Shefki Zeqiri tha se do të janë të gatshëm atë ditë për të shqyrtuar projektligjin dhe kërkoi informatë lidhur me projektligjin për OMGJ pasi që nuk kanë pranuar asgjë zyrtarisht nga Kuvendi. **Naim Maloku** njoftoi se projektligji në fjalë është tërhjekur me vendimin e seancës plenare, ndaj obligoi administratorin që të njoftoi MBPZHR lidhur me këtë, me çka kjo informatë do të jetë zyrtare për këtë ministri.

4. Të ndryshme

I. Pasi që është kërkuar nga përfaqësuesja e komisionit evropian të zvogëlohet numri i delegacionit të komisionit për vizitën në Bruksel për shkaqe financiare (prej 11+1 në 7+1), **Naim Maloku** pyeti komisionin a mundet me këtë formacion të sotëm të vendos lidhur me këtë kërkesë.

Selvie Halimi tha se tërhiqet nga delegacioni dhe nga vizita për shkaqe të obligimeve familjare, ndërkaq sugjerime tjera nuk kishte, ndaj nënkryetari propozoi që deri në mbledhjen e ardhshme të komisionit kjo çështje të përmbillet dhe mundësisht komisioni të kompletohet në numër.

II. Sipas konsultimeve verbale nga vizita në Mitrovicë, **komisioni të martën më 27.4.2010 duke filluar në orën 10,00 do të vizitoi liqenin e Batllavës** lidhur me aspektin mjedisor se a kemi ndotje të ujit të pijshëm apo jo. Komisioni do të shfrytëzoi mjetet financiare nga fondi për një drekë punuese me zyrtar të atjeshëm.

III. Me rastin e **ditës botërore të tokës**, komisioni bashkërisht me UNDP-NDI të enjten më 22.4.2010 në orën 10,30 organizon mbjelljen e fidanëve në sipërfaqen tokësore përreth Kuvendit të Kosovës. Anëtarët e Komisionit u ftuan nga kryesuesi që sa më numër të madh të prezantojnë në këtë ceremonial që do të organizohet.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 13,30.

Nënkryetari i Komisionit,
Naim Maloku